# DËSHMI ARKIVI

**A-469641**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, ripërtëritja e PD është jetike |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/berisha-shqiperia-ngjan-me-nje-te-semure-ne-urgjence-riperteritja-e-pd--i588397` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 17:00:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 17:35:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `da814dc28ebfb323fe36c22340f1042bbf27067398b443ff848e2abc42137d92` |
| TEKSTI | `65542a58be30b89bd315626130518cea50b2b549450fbcfe679f9779e7510e6c` |
| PAMJA | `dc61073e1ba256d203bb73bb8d8ba319d93ac2586ff7693ba9bb21e5ca5b8537` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b94b9d8a0eecbd9e12d9777658377d6d8984bbdd8502f31239c3bafe5f173faa` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `96339b4c2dc892b32bb4ef058b3a026fd313b806f95d2de1cfb905f974369f65` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b94b9d8a0eecbd9e12d9777658377d6d8984bbdd8502f31239c3bafe5f173faa`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, ripërtëritja e PD është jetike

TemA

25 Shtator 2026, 19:35Politika TEMA




Kreu lideri i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka deklaruar se Shqipëria ndodhet në një situatë kritike, duke e krahasuar vendin me një të sëmurë në sallën e urgjencës që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Sipas tij, ripërtëritja e Partisë Demokratike është jetike dhe përcaktuese për ripërtëritjen e Shqipërisë.

Duke folur nga Elbasani, Berisha theksoi se mbi 600 mijë pensionistë jetojnë me pensione të pjesshme, të cilat "absolutisht nuk mjaftojnë as për dy javë ushqime", pa përmendur ndihmën e familjarëve.

Ai përmendi gjithashtu të dhëna të fundit, sipas të cilave rritja e një fëmije në vitin e parë kërkon 66% të rrogës, ndërsa qiratë kanë arritur nivelin e pagës mesatare, duke e bërë blerjen apo qiradhënien e apartamenteve të paarritshme për shumicën e qytetarëve.

"Të gjithë këta faktorë shtyjnë qytetarët tanë të ikin, të ikin, të ikin," tha Berisha. Ai nënvizoi se Shqipëria është një vend me "pasuri përrallore të gjithanshme", por këto pasuri "janë shndërruar në mallkim për qytetarin shqiptar" dhe "në parajsë për qeveritarë të pangopur dhe hajdutë", të cilët, sipas tij, urrejnë qytetarin në mënyrë të ngjashme me ata që shtypën shqiptarët për 46 vite.

Berisha listoi probleme të rënda në shëndetësi dhe arsim, duke theksuar se "sirenat e nevojës për rithemelimin e Shqipërisë bien në të katër anët e vendit".

Duke iu drejtuar anëtarëve dhe mbështetësve të opozitës, ai vlerësoi qëndresën e tyre: "Keni meritë të jashtëzakonshme, sepse në kushtet më të vështira i qëndruat opozitarë... I qëndruat të pamposhtur pavarësisht nga dhuna, terrori, burgosjet, shantazhet dhe presionet." Sipas tij, pa këtë qëndresë, "ky regjim nuk ishte i shpërbërë në të sotmen".B

Berisha theksoi se fitorja e opozitës është një "domosdoshmëri" për të përfunduar "kilometrin e fundit drejt fitores". "Demokratët, populli opozitar pret fitoren. Shqipëria pret me padurim fitoren e opozitës. Dhe kjo është përgjegjësi e madhe ndaj vendit," përfundoi ai.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama publikon foto pak para fjalimit në OKB, Kryeministri pranë flamurit shqiptar]

18:55 Politika

Stina politike e Tiranës që inauguron ambasadori i ri i SHBA

17:33 Politika / 1 koment

Protestat në Nju Jork, Rama: S'më ndalin vezët dhe balta, flamuri shqiptar do vendoset majë Europës së Bashkuar

17:10 Politika / 14 komente

Ndryshime në qeveri, ja kush ikën dhe kush vjen!

17:05 Politika / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.